

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I QARKUT KUKES

VENDIM

Nr. 10 Date 12/02/2013

PER

**MIRATIMIN E RREGULLORES SE FUNKSIONIMIT TE KOMITETIT DREJTUES
PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS NDËRMJET AUTORITETEVE SHTETËRORE
PËRGJEGJËSE, NË NIVEL VENDOR, PËR REFERIMIN E RASTEVE TË FËMIJËVE NË
RREZIK**

Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme pasi shqyrtoi Relacionin dhe P/vendimin e paraqitur nga Njësia per te Drejtat e Femijeve prane Qarkut Kukës, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" nenet 7/2, 8/1b/d,12,13,54, ligjin Nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të RSH", ligjin Nr.9355 date 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore", ligjit Nr. 10 347, datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" si dhe VKM Nr.265, datë 12.4.2012 "Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij" pika 7, si dhe shkreses Nr.6 Prot. date 17.01.2013 te Agjensise Shteterore te Mbrojtjes se te Drejtave te Femijeve,

VENDOSI:

1. Të miratoje Rregulloren e funksionimit te Komitetit drejtues për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, prane Keshillit te Qarkut Kukës.
2. Për zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukës, Drejtoria e Sherbimeve Rajonale, Njësia per te Drejtat e Femijeve prane Qarkut Kukës, si dhe Drejtoria Juridike dhe Finances.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëhere

Konc: P.Vejseli

Ligjshmeria: G.Çejku

Sekretari: B.Ngjeçi



KRYETARI
Ibsen ELEZI

U hartua ne 4 (kater) kopje origjinale:

1. Zyres se Protokoll Arkivit
2. Institucionit te Prefektit Qarkut Kukës
3. Drejtorise Juridike dhe Finances

RREGULLORE

E FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT DREJTUES “PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS NDËRMJET AUTORITETEVE SHTETËRORE PËRGJEGJËSE, NË NIVEL VENDOR, PËR REFERIMIN E RASTEVE TË FËMIJËVE NË RREZIK“, PRANË KËSHILLIT TË QARKUT KUKES.

Neni 1

Parimet e veprimtarisë së Komitetit Drejtues

Komiteti Drejtues “Për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse, në nivel vendor, për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik“, pranë Këshillit të Qarkut Kukës, e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në parimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr.10 347 datë 4.11.2010, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve” si dhe në VKM Nr. 265, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”

Neni 2

Përbërja e Komitetit Drejtues

Përbërja e komitetit drejtues përcaktohet në bazë të VKM Nr. 265, datë 12.04.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij” si dhe në vendimin e Nr. date 2012 të Këshillit të Qarkut Kukës

Neni 3

Rregulli i mbledhjes së Komitetit Drejtues

1. Komiteti Drejtues mbledhet e diskuton problematikën e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik rregullisht, jo më pak se 2 herë në vit (çdo 6 muaj).
2. Në rastet e mbështetjes së fëmijëve në rrezik Komitetit Drejtues vepron si një komitet koordinues *ad hoc* dhe anëtarët e nevojshëm mbledhen sipas rastit.



Neni 4

Kryetari i Komitetit Drejtues

1. Kryetari i Komitetit Drejtues është Kryetari i Këshillit të Qarkut
2. Kryetari i Komitetit drejton takimet e Komitetit Drejtues dhe siguron zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 10 347, datë 04.11.2010.
3. Në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, Kryetari i Komitetit Drejtues, organizon punën për funksionimin e Komitetit .
4. Kryetari i Komitetit nxjerr urdhra dhe udhëzime sipas rastit.
5. Siguron bashkëpunimin dhe koordinimin e vazhdueshëm të të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.
6. Nënshkruan për të gjitha vendimet, marrëveshjet që vendosen në mbledhjet e Komitetit dhe procesverbalet e tyre.

Neni 5


Anëtarët e Komitetit Drejtues

1. Të gjithë anëtarët e Komitetit Drejtues janë të detyruar të marrin pjesë në mbledhjet 6 mujore të tij.
2. Në rastet kur njëri nga anëtarët nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, mungesa duhet të justifikohet dhe në takim duhet të delegohet një funksionar tjetër i institucionit, i cili ka të drejtë të votojë e të marrë angazhime në emër të drejtuesit të institucionit.
3. Në takimet kur Komiteti Drejtues vepron si komitet *ad hoc* për mbështetjen e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, nuk janë të detyruar të mblidhen të gjithë anëtarët e Komitetit Drejtues, por vetëm ata që janë të nevojshëm.
4. Anëtarët e nevojshëm pjesëmarrës në takimet *ad hoc* propozohen nga Njësia e të Drejtave të Fëmijës dhe thirren nga Kryetari i Komitetit.
5. Anëtarët e Komitetit Drejtues kanë detyrimin të angazhojnë të gjithë aktorët e nevojshëm të institucioneve që përfaqësojnë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.
6. Anëtarët bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë punën me njëri-tjetrin për gjetjen e zgjidhjes më të mirë, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës dhe mbajnë përgjegjësi për vendimet e marra në këto takime.

Neni 6

Pjesëmarrës të ftuar në mbledhjet e Komitetit

1. Në takimet e komitetit drejtues ftohen të marrin pjesë edhe përfaqësues të organeve të drejtësisë, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin ku e shtrin juridiksionin e tij Këshilli i Qarkut.



2. Këta përfaqësues ftohen nëse :
- a). kryetari e shikon si të nevojshme pjesëmarrjen e tyre.
 - b). kërkohet pjesëmarrja e tyre nga anëtarët e komitetit.

Neni 7

Thirrja e mbledhjes së Komitetit Drejtues


1. Thirrja e mbledhjes së Komitetit Drejtues bëhet nga Kryetari, i cili vendos për datën , kohën dhe vendin e mbledhjes së radhës.
2. Njoftimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.
3. Çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet i njoftohet çdo anëtar/e të Komitetit, në mënyrë që ata të njihen me këto ndryshime.
4. Për mbështetjen e rasteve të fëmijëve në rrezik, Kryetari thërret në mbledhje anëtarët e nevojshëm të Komitetit Drejtues, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit për rastin. Për rastet emergjente mbledhja thirret brenda 2 ditëve (48 orëve).

Neni 8

Funksionet e Komitetit Drejtues

Komiteti Drejtues shërben si mekanizëm kryesor në nivel qarku për zbatimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave fëmijeve dhe realizon misionin e tij përmes funksionit të:

1. Miratimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore në qark apo personave juridikë privatë për ofrimin e shërbimeve për fëmijët në rrezik.
 2. Nxitjes së njësisve të qeverisjes vendore për ngritjen e NJMF në bashki/komuna.
 3. Mbështetjes në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, të paraqitura nga Njësia për të Drejtat e Fëmijës, brenda afateve kohore të përcaktuar në VKM Nr. 265 datë 12.04.2012 dhe në nenin 7, pika 4 të kësaj rregullorje.
 4. Miratimit të planit të ndërhyrjes për rastet e fëmijëve në rrezik.
 5. Paraqitjes së propozimeve për masa dhe strategji rajonale konkrete për mbështetjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe politikave në mbrojtje të fëmijëve në nivel qarku dhe ia kalon ato institucioneve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.
 6. Miratimit të raporteve 6 mujore lidhur me aktivitetin e tij, problematikën e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik në territorin e qarkut dhe rastet e menxhuara.
- Një kopje të këtij raporti e dërgon tek Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.



Neni 9

Funksionet e Njesisë për të Drejtat e Fëmijës

1. Mbledh informacion mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve në qark dhe e shpërndan këtë informacion tek të gjithë anëtarët e Komitetit Drejtues
2. Përgatit raportin dhe materiale të tjera për takimin e rradhës së Komitetit Drejtues
3. Propozon nisma dhe masa të ndryshme për realizimin e të drejtave të fëmijëve.
4. Për rastin e fëmijës në rrezik, vë në dijeni Kryetarin e Këshillit, menjëherë pas marrjes së njoftimit.
5. I kërkon Kryetarit thirrjen e mbledhjes së Komitetit Drejtues për mbështetjen e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, sipas nenit 7 pika 4 të kësaj rregullorje, për:
 - rastet e konstatuara nga Njësia për të Drejtat e Fëmijëve,
 - rastet e bëra publike nga media.
 - rastet e referuara për mbështetje nga njësitë e qeverisjes vendore sipas përcaktimeve në VKM Nr. 265 date 12.04.2012.
6. Bën njoftimet e anëtarëve për takimin e komitetit dhe u dërgon atyre ftesën së bashku me axhendën.
7. Në rastet e mungesës së Kryetarit, Drejtori i Njesisë për të Drejtat e Fëmijës, drejton mbledhjen e Komitetit Drejtues.
8. Mban dhe përgatit proces-verbalin e mbledhjes së Komitetit Drejtues.
9. Mban të dhëna për fëmijët, për planin e ndërhyrjes dhe bashkë me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki/komunë ndjek ecurinë e rastit.

Neni 10

Për ruajtjen e fshehtësisë dhe konfidencialitetit

Anëtarët e Komitetit Drejtues, nuk japin të dhëna konfidenciale dhe kujdesen që të ruhet fshehtësia e të dhënave të fëmijëve dhe familjes.


Neni 11

Parashikime të fundit

Kjo rregullore mund të ndryshohet me aneks të veçantë në rastet e ndryshimit të detyrave.

Neni 12

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
Ibsen ELEZI